

VENDIMI I BORDIT TË FBK-SË I DATËS 11.09.2014

Bordi i FBK-së në mbledhjen e mbajtur më 11.09.2014 diskutoi për përgatitjet për sezonin 2014/15 dhe disa çështje tjera aktuale në basketbollin e Kosovës.

Bordi konstatoi se të gjitha klubet e Ligës së Parë dhe Ligës së Femrave kanë përmbushur obligimet financiare ndaj FBK-së nga sezoni i kaluar, që ka qenë parakushti themelor për të fituar të drejtën e garimit në sezonin 2014/15.

Bordi po ashtu konstatoi se vetëm dy klube nga të gjitha grupmoshat dhe të dyja gjinitë - KB Besa dhe KB Drita, nuk kanë plotësuar kriteret për licencim për sezonin 2014/15 dhe nuk kanë të drejtë të paraqitjes në gara.

Kriteret për licencim kanë qenë hapi i parë në një varg hapash që bordi ka ndërmarrë dhe do të ndërmerr me qëllim të institucionalizimit të veprimtarisë së basketbollit në Kosovës.

Bordi pret që kriteret për licencim do të ndikojnë që klubet të fuqizohen si institucione dhe si të tilla të sillen në raport me FBK-në si institucionin supreme për organizimin e basketbollit në Kosovë, në pajtim me Ligjin mbi Sportin.

Bordi në mbledhje rikujtoi se afati i fundit për përmbushje të obligimeve për ekipet e gjeneratave të reja është data 20.09.2014, duke konstatuar edhe njëherë me krenari se numri i klubeve të paraqitura është rekord në të gjitha kategoritë e reja.

Si rrjedhojë, ETC Superliga për edicionin 2014/15 do të numërojë gjashtë ekipe anëtare (Sigal Prishtina, Peja, Bashkimi, Trepça, Kastrioti dhe Vëllaznimi). Pikërisht për këtë arsye bordi ka vendosur që kalendari i garave të ndryshohet dhe sezoni të fillojë 04/05 tetor. Shorti për sezonin e ri për të gjitha ligat e seniorëve do të tërhiqet publikisht më datën 14.09.2014. Për detajet e procedurës të gjitha palët do të njoftohen me kohë.

Bordi vendosi që afati i rregullt kalimtar të përfundojë më datën 20.09.2014 në ora 16:00.

Bordi autorizoi Komesarin e Garave që të harrojë kalendarin e ri të garave deri më datën 12.09.2014 në ora 16:00 dhe ta dërgojë atë për aprovim në bord.

Basketball Federation of Kosovo, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo
www.basketbolli.com , email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080

Në këtë mbledhje u formalizua marrëveshja ndërmjet Bordit të FBK-së dhe KB Bashkimit për organizimin e Salamander Superkupës së Kosovës, më 21 shtator në Prizren.

Bordi miratoi Vendimin sipas së cilit FBK-ja në kuadër të ndihmave materiale dhe me pajisje sportive që u jep klubeve, të sigurojë uniforma sportive për klube të ETC Ligës së Femrave dhe pajisje sportive dhe uniforma për reprezentacionet e Kosovës në grupmoshat e reja.

Bordi vendosi që një delegacion katër anëtarësh i FBK-së, si mysafirë të Federatës Turke të Basketbollit, të marrë pjesë në fazën finale të Kampionatit Botëror të Basketbollit për Femra Turqia 2014, ku do të zhvillojë takime me krerët dhe zyrtarët e lartë të FIBA-s dhe federatave kombëtare.

Bordi vendosi që të dërgojë disa trajnerë të basketbollit të femrave në klinikën ndërkombëtare të basketbollit që mbahet në Stamboll në kuadër të Kampionatit Botëror.

Kryetari i FBK-së

Erolld Belegu

Basketball Federation of Kosovo, Lagjja Arbëria, Objekti C2/11, Lokali nr. 4, 10000, Prishtina, Kosovo
www.basketbolli.com , email: info@basketbolli.com, tel: +381 38 704 101; mob: +386 49 738 080